



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.shk.II.nr.1345/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditoritme seli në Prishtinë, Rr. "...", në Lagjen, Filialë e SHPK, të cilën e përfaqëson Xhemail Ferati, nga Ferizaj- "Avokatura Istrefi" me seli në Prishtinë, kundër debitorit Ndërmarrja sh.a, me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.49/2020 të dt. 11.06.2020, jashtë seancës me datën 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit Ndërmarrja sh.a, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.49/2020 i dt. 11.06.2020, ashtu që vendoset si në vijim: APROVOHET prapësimi i debitorit Ndërmarrja" sh.a, me seli në Prishtinë, i ushtruar ndaj Urdhrit për përmbartim P.nr.500/19 dt. 24.12.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, si i bazuar, SHFUQIZOHET në tërësi (vihet jashtë fuqie) Urdhri për përmbartim P.nr.500/19 dt. 24.12.2019 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi dhe abrogohen të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra në këtë çështje, ndërsa Propozimi për përmbartim i kreditorit, me seli në Prishtinë, REFUZOHET SI I PA BAZUAR.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin e atakuar PPP.nr.49/2020 të dt. 11.06.2020, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Ndërmarrja sh.a, me seli në Prishtinë, të ushtruar kundër Urdhrit P.nr.500/2019, të datës 24.12.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, në Prishtinë dhe e ka lënë në fuqi urdhrin në fjalë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që e njëjta të aprovohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar të priset si i kundërligjshëm, respektivisht i pa bazuar në dispozita pozitive në Kosovë dhe në provat e dëshmuara nga debitori, dhe lënda të kthehet në rivendosje, ose çështjen ta vendos vet mbi bazën e provave të ofruara nga debitori, si dhe të obligohet kreditori ti bartë vet shpenzimet e procedurës.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Restaurant &”, me seli në Prishtinë, Rr. “....”, në Lagjen, Filialë e SHPK, me dt. 24.12.2019, ka paraqitur propozim për përmbare në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr..... të datës 30.08.2016, në shumën prej 104.60 € (përfshirë TVSH-në), dhe të pranuar nga debitori të njëjtën ditë, si dhe faturës nr..... të datës 01.08.2016, në shumën prej 32.70 € (përfshirë TVSH-në), dhe të pranuar nga debitori të njëjtën ditë, gjithsejtë për dy faturat shumën e përgjithshme prej 137.30 €.

Përmbaresi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbare të kreditorit me urdhrin përmbare P.nr.500/2019 të dt. 24.12.2019, e ka lejuar përmbaremin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 06.01.2020, ka ushtruar prapësim duke propozuar që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe Urdhri Përmbare të refuzohet si i pathemeltë dhe i parashkruar, duke e detyruar kreditorin që ti bartë të gjitha shpenzimet procedurale. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke propozuar që prapësimi të refuzohet si i pa bazuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën e përcaktuar prej 156 €.

Gjykata themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të prapësimit si dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.49/2020 të dt. 11.06.2020, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit, më decidivisht sikur në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar se propozimi i kreditorit për përmbare në bazë të dokumentit të besueshëm- faturave është parashtruar me datë 24.12.2019, ndërsa borxhi ka të bëjë me faturat që i përkasin gushtit të vitit 2016, e të cilat sipas kreditorit janë pranuar me datë 18.08.2018. Duke u bazuar në nenin 355 të LMD –së dhe konstatimet si më lartë gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit. Borxhi ka të bëjë me faturat që i përkasin gushtit të vitit 2016, e të cilat sipas kreditorit janë pranuar me datë 18.08.2018, në pajtim me dispozitat e nenit 378 par.1 pika 1.1 të LMD-së, (ligji i vitit 1978), parashkrimi në mes të subjekteve ekonomike, gjegjësisht afati

i parashkrimit është 3 vite, debitori e ka konfirmuar se me datën 18.08.2018 i ka pranuar faturat, ndërsa propozimi për përmbarim është parashtruar me datën 24.12.2019, pra pas një viti, katër muaj e gjashtë ditë, gjegjësisht brenda afatit tre vjeçar. Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe pretendimin tjetër të debitorit se i njëjti pas pranimit të faturave, të njëjtat i ka kundërshtuar me arsyetim se personi që i ka shfrytëzuar pijet dhe ushqimin nga kreditori është i panjohur për debitorin, përkatësisht nuk është person i autorizuar zyrtar i debitorit, por një pretendim të tillë gjykata e vlerësoj si të pa bazuar, duke u mbështetur në nenin 69 par.4 të LPP-së, duke shtuar se edhe pse debitori edhe pse i është referuar provave lidhur me kundërshtimin e tij që i ka bërë faturave, pra e-mailave zyrtare, të njëjtat nuk i ka bashkangjitur.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat dhoma e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës të pretenduara, mirëpo gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të drejtë, nga ku rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 21, 22 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 24 par 3 dhe 5, 69 par 4 të LPP-së lidhur me nenin 355 të LMD-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë atë se çka konsiderohet dokument i përshtatshëm për përmbarim dhe vendosjes lidhur me parashkrimin e kërkesës.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm- faturat me nr. nr.... të datës 30.08.2016, në shumën prej 104.60 € (përfshirë TVSH-në), si dhe faturës nr..... të datës 01.08.2016 në shumën prej 32.70 €, mirëpo të njëjtat fatura sipas vlerësimit të kësaj gjykate, e në mbështetje të nenit 355, paragrafi 1, dhe 2 të LMD-së, (Ligji 04/L-077) kanë arritur afatin e parashkrimit.

Me nenin 355, paragrafi 1, dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve përcaktohet se: “*Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vjet. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.*” Ndërsa dispozita nga neni 369 par 1 të

LMD –së, përcakton se: “*Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*”

Me këto dispozita përcaktohet se afati i parashkrimit të kërkesave reciproke nga kontratat komerciale është 3 vite, ndërsa nga shkresat e lëndës vërtetohet se fatura e fundit për të cilin kreditori kërkon përmbarrimin, pra fatura me nr. nr..... është e datës 30.08.2016, kurse propozimi për përmbarrim është paraqitur me dt. 24.12.2019, me ç rast rezulton që i njëjti është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, brenda të cilit kreditori ka të drejtë që të kërkoj përmbarrimin.

Në këtë kontekst, si i pa drejtë del vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me mos parashkrimin e kërkesës ku ka arsyetuar se debitori ka pranuar faturat me dt. 18.08.2018 dhe nga kjo datë deri në iniciimin e propozimit për përmbarrim nuk kanë kaluar 3 vite, për faktin se nga interpretimi i dispozitës së nenit 355 par 2 të LMD -së, kjo gjykatë gjeti se afati i parashkrimit të kërkesës nga kontrata komerciale fillon të rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e jo nga pranimi i faturave siç gjykata e shkallës së parë ka interpretuar. Pra kjo gjykatë vlerëson se afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë prej dërgimit të mallit e që është dt. 30.08.2016, ndërsa propozimi për përmbarrim është paraqit me 25.12.2019, pra pas kalimit të afatit prej 3 viteve, që do të thotë se kërkesa është parashkruar. Po ashtu në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilin debitori ka pohuar borxhin si në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, fakt i cili do të ndikonte në ndërprerjen e parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së.

Nga këto arsye, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson ndryshe provat nga shkresat e lëndës dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarrimit, si dhe të refuzohet propozimi për përmbarrim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Sa u përket shpenzimeve të procedurës, u vendos konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së duke vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta, pasi që e debitori nuk i kishte kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika c) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1345/22 dt. 05.09.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha